



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office of the Chief
State Prosecutor**

A. nr. 19 /13

Datë 28.01.2013

P R I S H T I N Ë

KRYEPROKUROREVE TE PROKURORIVE THEMELORE

Ferizaj, Gjakove, Gjilan, Mitrovice, Peje, Prishtine dhe Prizren

KRYEPROKURORIT DHE ZEVENDESKRYEPROKURORIT TE PROKURORISE
SPECIALE TE REPUBLIKES SE KOSOVES

Prishtine.

Dispozitat e Kodit te Procedures Penale te Kosoves, neni 101 paragrafi 2 dhe neni 240 ne shikim te pare jane ne kundeshtim me njeri tjetrin.

Kolegiumi i prokuroreve te Zyres se Prokurorit te Shtetit per zbatimin e ketyre dispozitave ka marre kete

Q E N D R I M

Sipas nenit 240 paragrafi 1 te KPPK prokurori i shtetit mund te paraqes aktakuze te ashtuquajtur " te drejteperdrejte" per te gjitha veprat penale te parapara me KPK nese nga kallximi penal posedon informacione te cilat dhene prova per ekzistimin e dyshimit te bazuar mire per vepren penale dhe kryesin e saj.

Kete qëndrim Kryeprokuroret do t'ua përcjellin te gjithë prokuroreve te prokurorove te cilat ata i drejtojnë.

Arsyetim

Dispozita e nenit 101 eshte dispozita e pare e nënkapitullit 4 te kapitullit te IX te KPPK qe rregullon fillimin e procedures dhe flet per dy qeshtje, per fillimin e hetimit dhe ngritjen e aktakuzes.

Ne paragrafin 2 te këtij neni rrjedhe se aktakuza mund te paraqitet vetem per vepra penale te denueshme deri ne tri vjet nese provat vetetojne dyshimin e bazuar mire se eshte kryer veper penale dhe se i dyshuari eshte kryes i saj.

Kjo dispozite, neni 101 ka per qellim qe ne rradhe te pare te rregulloje procduren e hetimit dhe te aktaukezes lidhur me veprat penale te denueshme deri ne tri vjet burgim.

Dispozita e nenit 240 eshte dispozite paresore lidhur me aktakuzen dhe ka perparesi ndaj dispozites se nenit 101 paragrafi 2. Kjo dispozite parasheh se aktakuza mund te ngritet edhe pa zbatimin e hetimit per te gjitha veprat penale te parapara me KPK kur prokurori ka prova per ekzistimin e dyshimit te bazuar mire. Prokuroret duhet te aplikojne kete dispozite dhe te paraqesin aktakuza, pa filluar dhe zbatuar paraprakisht hetimin, cdo here kur nga kallximi penal kane prova qe mbeshetetsin dyshimin e bazuar mire se i pandehuri ka kryer vepren penale. Prokurorin e Shtetit nuk e lidh kualifikimi juridik i vepres penale i dhene nga paraqitesi i kallsimit penal.

KRYEPROKUROR I SHETIT

Ismet Kabashi

